



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 395/1 Prot.

Tiranë, më 28. 05. 2020

V E N D I M

Nr. 54 , Datë 28. 05. 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 20 Regj., datë 10.03.2020, të shtetasit I. K., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, subjekti ankues është shprehur se, me datë 21.02.2020 nga ana e autoriteteve të IEVP Peqin i është komunikuar kalimi në regjimin 41-biz, për shkak se është dënuar sipas neneve 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Ai ka pretenduar se kjo është padrejtësi në drejtim të tij, pasi është dënuar një herë dhe nuk mund të dënohet rishtaz duke i dhunuar të drejtat dhe duke e diskriminuar. Ai citon se: “*Që të kalohet në regjimin 41-biz duhet të vërtetohet lidhja shkakësore që mban aktivitetin kriminal me botën e krimit jashtë burgut. Një fakt i tillë nuk provohet kundrejt meje*”.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pezullimin e Urdhrit të DPB për kalimin e tij në regjimin 41-biz.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27 (ish-Ministria e Mjedisit) Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 450 prot., datë 11.03.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues² DPB, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 977 077 304 AA, rezulton se DPB-ja ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme dhe megjithatë nuk solli asnjë përgjigje zyrtare.

2. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 450/1 prot., datë 11.05.2020, Komisioneri iu drejtua sërisht DPB.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit të sipërpërmendur, për të dërguar informacionin e kërkuar me shkresën nr. 450 prot., datë 11.03.2020, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e saj, duke i sjellë në vëmendje institucionit se mosplotësimi i tij, pengon shqyrtimin e ankesës, si dhe përbën shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 2920/2 prot., datë 22.05.2020 DPB ka informuar Komisionerin se:

“Për shtetasin I. K. nuk ka asnjë urdhër për kalimin e tij në regjim të posaçëm në zbatim të ligjit nr. 108/2018 e madje ndaj asnjë të burgosuri tjetër. Shtetasi I. K. vijon të jetë në regjim normal, në IEVP Peqin, sipas përcaktimeve të urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal për dënimin e tij. Nga administrata e institucionit të burgimit, trajtimi i tij është i njëjtë si më të gjithë të dënuarit e tjerë të akomoduar aty, pa u ndikuar në gjendjen e tyre ekonomike, ngjyrën apo elementë të tjerë.

² Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimi i DBP, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të Urdhrave përkatës të DPB lidhur me kalimin e subjektit ankues në regjimin 41-biz. (Bashkëlidhur procedura e ndjekur për subjektin ankues).
- Çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Garantimi i të drejtave të tyre, zbatohet në mënyrë të plotë në përputhje me aktet rregullative që normojnë fushën e veprimtarisë në institucionet e burgimit si: korrespondenca, trajtimi në ushqim dhe ai shëndetësor, aktivitetet normale ditore, këshillimi ligjor dhe trajtimi edukativ në funksion të rehabilitimit dhe ri-socializimit të tyre, etj. Madje për më tepër, për të dënuarin I. K. nga komisioni i posaçëm i punësimit në IEVP Peqin, i është ofruar edhe mundësia e punësimit, të cilën nuk ka pranuar. Evidentojmë se ushtrimi i punësimit në IEVP-të nga të burgosurit, nuk përbën thjeshtë një komponent i procesit të rehabilitimit të tij, por gjithashtu ndikon edhe në përfitimin e një ulje të konsiderueshme të masës së dënimit me burgim për efekt të përfshirjes në këtë proces”.

Në përmbyllje të parashtrimeve të saj, DPB thekson se, pretendimi i subjektit ankues është i pavërtetë dhe deklarativ, i pabazuar në asnjë akt shkresor a urdhër, qoftë ai dhe verbal.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe diskriminues të pretenduar nga subjekti ankues.

Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë i njohur ndryshe si sistemi “41 bis”, përfaqëson në vetvehte një proces “*siu generis*” të rëndësishëm, në funksion të parandalimit të aktivitetit kriminal dhe garantimit të rendit dhe sigurisë në botën e jashtme dhe në institucionet e burgimit.

Modalitetet e aplikimit të regjimit “41 bis” dhe garancitë e të dënuarve subjekte potenciale, janë të përcaktuara në mënyrë taksative në ligjin nr. 108/2018 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve*”, i ndryshuar, konkretisht:

- Kalimi në regjim të posaçëm në referencë nuk kryhet me urdhër të DPB, por me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
- Propozimi për aplikimin e regjimit “41 bis”, u është ngarkuar disa institucioneve të specializuara në fushën e mbrojtjes së rendit dhe sigurisë në vend apo transnacionale.
- Rrethi i subjekteve potenciale të aplikimit të regjimit në fjalë është i lidhur drejtëpërdrejtë dhe ngushtësisht, me llojin e veprës penale të kryer/apo hetuar si dhe format e strukturuara të bashkëpunimit si dhe ato me qëllime terroriste.
- Ekzekutimi i kalimit në regjimin “41 bis” i subjekteve përkatëse bëhet në ambiente të dedikuara për këtë qëllim si dhe me një plan masash specifike, duke përfshirë edhe aktivitetin ditor të tyre.
- Për çdo aplikim i regjimit “41 bis”, subjektit të kësaj mase i garantohet pozita e tij juridike nëpërmjet njoftimit të saj, mjeteve ligjore ankimore dhe gjyqësore në përputhje me procedurat dhe afatet kohore përkatëse.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa mësipër, rezultoi se:

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Bazuar në faktet e deklaruara në përgjigjen zyrtare të DPB, gjykojmë se shtetasi I. K., nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e DPB, përse kohë pretendimi i tij është i pabazuar në ndonjë akt/urdhër shkresor apo verbal, duke ngeluar thjeshtë në kuadrin e një pretendimi deklarativ.

Referuar përgjigjes zyrtare të DPB³ rezulton se për këtë shtetas nuk ka asnjë urdhër për kalimin e tij në regjim të posaçëm në zbatim të ligjit nr. 108/2018 e madje ndaj asnjë të burgosuri tjetër. Shtetasi I. K. vijon të jetë në regjim normal, në IEVP Peqin, sipas përcaktimeve të urdhrat të ekzekutimit të vendimit penal për dënimin e tij.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se nga ana e DPB, nuk janë ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo të padrejtë.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DPB-së, për shkaket e pretenduara nga shtetasi I. K.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

³ Neni 190, i Kodit Penal ka parashikuar përgjegjësinë e çdo subjekti juridik lidhur me vërtetësinë e aktit/dokumentit zyrtar që lëshon: “Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet”.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit I. K., për shkaqet⁴ e pretenduara prej tij, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja ekonomike dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

⁴ Për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.